



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec/Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. I prot. 1969 Më 28.06.2018
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

**KORNIZA
AFATMESME
BUXHETORE (KAB) e KOMUNËS
SË RAHOVECIT
2019-2021**

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

2018

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2019-2021

3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2019-2021


3.6. Analiza Gjimore

I. Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore KAB që po prezantojmë është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu KAB siguron mekanizmat e nevojshëm për arritjen objektivat prioritare, të identifikuara në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2019/2021-I të lëshuara nga Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2019-2021. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. Strategjia Zhvillimore Komunale - Deklarata e Prioriteteve Afatmesme

Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën jugore të Kosovës, në rajonin e Dukagjinit (Gjegjësisht në subrajonin e Podrimës). Është njëra nga komunat e mesme me popullsi, pozita gjeografike që i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Rahovecit ka gjithsej **33** fshatra dhe **3** vendbanime dhe një qendër urbane e ndarë në **5** lagje me një popullsi prej **56,208** banorë sipas regjistrimit të vitit 2011, të organizuar në **8.028** ekonomi familjare.

Mbi **2966** biznese operojnë brenda komunës tonë, bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Rahovecit, afërsisht gjysma e tyre (50%) merren me veprimtari tregtare, 15% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 16% në prodhimtari, 19% me transport.

Administrata e Komunës së Rahovecit është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit, nga të cilat një është e vendosura në ndërtesën administrative të komunës dhe 8 të tjera në fshatra.

Vizioni i mëposhtëm për Komunën e Rahovecit i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2019-2021 (I & II) të lëshuar nga ministria e Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Rahovecit është të jetë qendër e zhvillimit ekonomik, me një Bujësi të zhvilluar, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për gjithë qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attribute të ndërlidhura njëra me tjetrën, prioritet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në pesë prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Këto prioritete janë:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Krijimi i zonave ekonomike dhe industriale.
- Lehtësira në të bërit biznes, lirim nga taksa e bizneseve prodhuese.
- Mbështetje direkte dhe indirekte bizneseve.
- Mbështetja e Turizmit ,dhe Agro Turizmit.
- Rritja dhe modernizimit i tregjeve
- Këshilla dhe sugjerime në të bërit biznes
- Infrastruktura rrugore

2. Forcimi i Sektorit të Bujqësisë

Rritja e ekonomisë komunale përmes zhvillimit të sektorit të bujqësisë duke i përkrahur direkt e komunës së Rahovecit,

- Subvencionimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor duke i klasifikuar për secilin sektor si:
 - 1. Perim Kultura,dhe Pëmtaria - Mekanizëm bujqësor (Benac, spërkatëse, pullug, etj)
 - 2. Përkrahje me sera me sipërfaqe deri në 10 ari
 - Subvencionimi i fermerëve me farëra, pleh kimik dhe në përgjithësi me inpute bujqësore
 - Sektori i Blegtorisë - përkrahje ne makina mjelëse,
 - Sektori i Bletarisë, - Koshere për blete, pajisje për trajtim dhe ruajtje te mjaltit etj.
 - Sektori i vreshtarisë-inventar për trajtim te rrushit pas vjeljes
- Një theks i veçantë për të gjitha sektorët do të orientohet në sigurim të tregut për fermer, këtë formë do të mundohemi duke përkrahur:
- Fuqizimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese te pemëve dhe perimeve
 - Fuqizimi dhe përkrahja e bodrumeve për përpunimin e rrushit
 - Hapjen e tregjeve të reja në lokalitete të Komunës sonë si, Funksionalizim i tregut ne Ratkoc, funksionalizim i tregut në Xerxe, funksionalizimi i tregut në Krushë të Madhe e po ashtu edhe 2 tregjeve të reja në qytet të Rahovecit, po ashtu vazhdimin e fazës së dytë të projektit “Infrastruktura e tregut të rrushit-të Shtëpia e verës vendi ku mbahet Hardh Fest”
 - Fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, Stimulimi i tyre për të pasur mundësi të përpunimit të qumështit dhe nxjerrjen produkteve tjera përcjellëse nga qumështi.
- Duke e ditur që për një zhvillim me të madh dhe me të qëndrueshëm rendësi të madhe ka infrastruktura në sektorin e bujqësisë, do të kujdesemi që:
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore,
 - Ndërtimin e kanaleve të kullimit ne zonat ku paraqiten vërshimet
 - Zgjerimi i sistemi te ujitje në zonat ku mungon,
 - Krijimi i fondit për Emergjenca etj.

Në sektorin e pylltarisë, do të i jepet prioritet pyllëzimit të hapësirave të reja në tërë territorin e komunës. Toka e cila është nën menaxhim të agjensionit pyjor do të trajtohet me shumë kujdes dhe nuk do të lejohet degradimi dhe keqpërdorimi i saj.

3. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe rritja e cilësisë në arsim

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimi i shkollave të reja.
- Investime në mjete konkretizimi, laboratorë, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Funksionalizimi i përhershëm dhe bashkëveprimi i organeve drejtuese të shkollave, Këshillave Drejtuese të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve
- Angazhimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike në shkolla
- Angazhimi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimmdhënësve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.
- Ndërtimi i çerdheve për fëmijë.

4. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

- Subvencionim për rastet e sëmundjeve personave pa të ardhura/të ardhura të ulëta,
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile ,
- Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore etj.
- Krijimi i kushteve më të mira për stafin shëndetësor,
- Kujdesi palativ Kujdesi shtëpiak,
- Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse,
- Parandalimi i sjelljeve të këqija Droga, Duhani dhe Alkooli,
- Ofrimi i shërbimeve për të gjithë qytetarët në mënyre të barabartë

Rehabilitimi i pacienteve me sëmundje mentalejimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

5. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi),
- Zgjerim i rrjetit të kanalizimit,
- Përmirësimi të standardeve ambientale,
- Përmirësimi dhe zgjerimi i ujit të pijes,
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara etj,
- Përmirësimi i gjendjes së lumenjve,
- Rritja e numrit të drunjtëve dekorativ,
- Pyllëzim. etj

6. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

- Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:
- Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyrave komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve.
- Zgjerimi i sporteleve në zyrat e gjendjes civile
- Sisteminimi zyrtarëve të zyrës së pranimit, Kadastrës dhe arka, në një hapësirë të përbashkët, për qëllimin shkurtimin e kohës për palët
- Rregullimi i sporteleve të veçanta për mërgatën
- Vendosja e E-Kiosk – për shërbimet e shpejta dhe efikase për palë.

7. Rini kulturë dhe sport

- Mbështetja e sektorit të kulturës (subvencionimi i shoqërive të ndryshme),
- Krijimi i rrjetit të OJQ-ve,
- Funksionalizimi i kuvendit të rinjve,
- Krijimi i teatrit amator të Qytetit,
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë,
- Intervenimi në monumentet kulturo-historike, dhe mirëmbajtja e tyre,
- Pasurimi i fondit librar në bibliotekat e Komunës tonë,
- Ndërtimi i terreneve të reja sportive,
- Ngritja dhe mbështetja e të gjitha klubeve sportive etj.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejtë politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën 1. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2019-2021 të përpiluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2019-2021 ku parashihet një rritje reale vjetore, 4.78 % në vitin 2019, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendi në 2019 - 2021 parashihet të jetë 4.81% respektivisht 5.14%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkethehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme ulët me 1.6 %, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të hyrat vetanake dhe 2. Grantet qeveritar.** Komunitat po ashtu janë pranues të garantëve të donatorëve të jashtëm dhe të brendshme (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve), si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna Rahovecit në periudhën afatmesme buxhetore 2019-2021 planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj ne projektet për menaxhimin e ujerave të zeza, për të cilën hua garantuese do të jete Qeveria e Republikës së Kosovës siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Pershkrimi	2018	2019	2020	2021 (vleresim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	4.0	4.78	4.81	5.14
Inflacioni në %	2.7	2.40	2.30	2.10
BPV për kokë banori, në euro	3.261	3.402	3.562	3.856
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	56.208	56.208	56.208	56.208
Numri i bizneseve të regjistruara	2450	2.966	3.020	3.050
Numri i nxënësve	12.871	10.841	10.830	10.820

Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2019-2021

3.2 Të Hyrat Komunale dhe Parashikimi Afat-mesëm 2019-2021

Të hyrat e Komunës së Rahovecit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunës në vite (2019 – 2021), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2019 grantet qeveritare për Komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej 3.87%. Rritje e granteve qeveritare do të jetë përafërsisht 3.87% në vitin 2019 në krahasim me 2018, ndersa në krahasim me vitin 2018 dhe 2021 kemi rritje prej 23.72% sipas të dhënave të prezantuara në tabelën më poshtë, kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, sic parashihet me KASH-in 2019-20201

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar zvoglim (rrenje) për -29.17% të ndjeshme nga viti në vit po ashtu. Të hyrat vetanake të planifikuara zvogëlim nga viti 2019-2021 përafërsisht -24.28% në krahasim me vitin 2018. Kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat nga tatimi në pronë ku nga vitit 2018 planifikohet te fillohet edhe tatimi i tokave, si dhe implementimi i taksës për mbeturina. Realisht nëse shikojmë planifikimin nga viti 2019 deri në vitin 2021 zvogëlimi i të hyrave vetanake të planifikuara do te jete -24.28%. Ky zvogëlim vjen pas planifikimit për të filluar grumbullimit e taksës për mbeturina e që është një sfidë në vete që do të përballemi në vitin 2019 qe kap një shumë mbi 140,000.00 euro.

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2019-2021, në Euro

Burimi i të hyrave	2018	2019	2020	2021
Totali i buxhetit	13,698,2312.00	13,658,892.00	14,104,146.00	14,620,755.00
Granti qeveritar (10)	11,862.730.00	12,321,510.00	12,895,077.00	13,371,384.00
Granti i përgjithshëm	5,060,838.00	5,231,296.00	5,695,256.00	6,057,607.00
Grani i shëndetësisë	1,564,828.00	1,686,240.00	1,770,552.00	1,859,080.00
Granti i arsimit	5,214,321.00	5,380,480.00	5,405,772.00	5,431,203.00
Huamarrja ne arsimit	50,575.00	33,719.00		
Keshilli I Hoqes se Madhe	22,743.00	23,494.00	23,494.00	23,494.00
Huamarrja-ne shendetesi	134,899.00	134,899.00		
Të hyrat vetanake (21)	1,650,027.00	1,168,757.00	1,209,069.00	1,249,371.00
Drejtoria për Financa dhe Buxhet	445,000.00			
Tatimi në Pronë	340,000.00			
Taksa tjera administrative	5,000.00			
Taksat rrugore	100,000.00			
Drejtoria për Administratë	100,000.00			
Taksa e pjesëmarrjes në tender				
Taksa Certifikatat Tjera Ofiqarie	20,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	10,000.00			
Taksa Certifikatat e lindjes	50,000.00			
Taksa Certifikatat e kurorëzimit	15,000.00			
Taksa Certifikatat e vdekjes	5,000.00			
Shitja e shërbimeve				
Drejtoria për Ekonomi	153,000.00			
Licenca per aktivitete individuale				
Licenca per pranimin teknik te lokalit				
Takse per ushtrimin e veprimtarisë	80,000.00			
Qiraja nga objektet publike	72,000.00			
Licencat per shërbimet profesionale	0.00			
Tax administrative per fletëkërkesë	1,000.00			
Licenca tjera per afarizem	0.00			
Drejtoria për KRS	5,000.00			
Pagesa e bibliotekës dhe sallës	5,000.00			

Drejtoria për Urbanizëm	109,000.00			
Taksa komunale per leje ndërtimi	32,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	5,000.00			
Taksa për demolim	2,000.00			
Taksa per legalizimin e objekteve	45,000.00			
Shfrytëzimi i pronës publike	25,000.00			
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	99,000.00			
Taksa regjistrimin e trashëgimisë	37,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	42,000.00			
Shfrytëzimi i pronës publike	0.00			
Taksa per matjen e tokës ne terren	20,000.00			
Drejtoria e shërbimeve publike	425,000.00			
Taksa komunale per leje - gërmim	2,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	1,000.00			
Taksa per mbeturina	400,000.00			
Shfrytëzimi i pronës publike	12,000.00			
Qiraja nga vendosja e objekteve tregtare	10,000.00			
Drejtoria e Inspektionit	6,000.00			
Taksa administrative për fletëkërkesë	6,000.00			
Gjobat nga inspektorati				
Gjobat tjera				
Drejtoria për Bujqësi	13,000.00			
Taksa ndërrimi i destinimit të tokës				
Taksa administrative për fletëkërkesë	2,000.00			
Taksa nga licen. I zhavorit e gurëthyes				
Taksa -të hyrat nga pyjet	1,000.00			
Qiraja e tokës bujqësore	10,000.00			
Drejtoria për mbrojtje dhe siguri civile	220,000.00			

Largimi dhe deponimi i automjeteve				
Tax administrative per fletëkërkesë				
Gjobat ne trafik	100,000.00			
Gjobat në trafik nëpërmjet gjykatës	120,000.00			
Inspektimi i instal zjarr & komunaleve				
Inspektimi i ambientit				
Arsimi	25,027.00			
Te hyrat nga taksat -Të hyrat nga Çerdhja	13,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	1,000.00			
Participim per arsim joformal	11,027.00			
Shëndetësia	50,000.00			
Participimi nga shëndetësia	48,000.00			
Taksa administrative per fletëkërkesë	2,000.00			

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90 % të buxhetit total të komunës.

3.2.1 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Financimi nga donatorëve e jashtëm dhe te brendshëm do të vazhdoj edhe gjate viti 2019-2021 në shume fusha si në arsim, infrastrukture, menaxhimin e mbeturinave, ujerave të zeza etj.

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Rahovecit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka iniciuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të iniciuara në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2018-2021, sugjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2019 dhe 2021 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Rahovecit kjo do të

vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grantin e arsimit, sidomos duhet pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.

Së treti, Komuna e Rahovecit ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Tutje, Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë të cilën në të ardhmen ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike.

Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Rahovecit, është edhe politika që do të zgjidhet nga viti 2019 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Rahovecit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërimë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politika.

Së pesti, Komuna e Rahovecit ka mirëprit deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrat vetanake komunale.


Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht eliminimit të atyre taksa e ngarkesa komunale që rëndojnë ambientin biznesor komunal. Edhe në të ardhme barra kryesore në realizimin e hyrave vet anakë bie mbi tatimin në prone.

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2019-2021

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore komunale 2019 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2019, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Rahovecit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2019 do ti paraqesim sipas kategorive ekonomike që aktualisht janë funksionale (figura 2)

➤ Pagat dhe mëditje	7,391,529.00 €;
➤ Mallrat dhe Shërbim	1,409,704.00 €;
➤ Shpenzimet Komunale	255,500.00 €;
➤ Subvencionet dhe Transferet	196,650.00 €;
➤ Shpenzimet Kapitale	4,405,509.00 €
TOTAL	13,658,892.00 €



3.3.1 Pagat dhe Mëditjet – Gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018, kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet 0.5 % si rezultat i vendimit të qeverisë për pagesën e stazhit të punës. Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës 2019-2021 pritet të rritet me një mesatare vjetore prej 0.8 % bazuar në KASH-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rritja me e lartë prej rreth 9.8% në këtë kategori pritet të ndodhë gjatë vitit 2019, si rezultat i implementimit të legjislacionit sekondar që ka të bëjë me reformën në administratën publike, ndërsa për vitet vijuese kjo kategori pritet të rritet ndjeshëm. Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet përgjithshme buxhetore komunale, gjatë këtyre viteve, pritet të mbetet në nivel të përafërt **53.93 %**.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet - kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalit), është rritje për **90.05 %** nga viti 2017 në vitin 2019, edhe pse kemi rritje të konsiderueshme të shpenzimeve të kësaj kategorie e cila kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve **për pagesën e mbeturinave**, për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale shkollave, pagesat për ndriçimet publike, shërbimet e varrimit, pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve komunale, punkteve shëndetësore, objekteve sportive etj), rritjes së nevojave për material shpenzues (lëndë djegëse dhe karburante në proporcion me zgjerimin sipërfaqeve të objekteve të reja). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore, gjatë këtyre 3 vite të ardhshme pritet të jetë mesatarisht **12.43 %**.

3.3.3 Subvencionet – Në vitin 2019 komuna e Rahovecit do të ndajë subvencionet për bujqësi, shëndetësi, arsim, kulturë, rinë dhe sport. Nga viti 2018 shpenzimet për shërbimet e varrimit janë tërhequr nga kjo kategori, por nga kategoria e subvencioneve do të paguhet bursat për studenteve. Pjesëmarrja e subvencioneve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore gjatë viteve 2019-2021 mesatarisht do të **1.76 %**.

3.3.4 Investimet Kapitale - Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2019, për **9.5%** krahasuar me vitin 2018. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Rritja në investimet kapitale, nga buxheti i komunës do të përmirësohet nga viti 2019, mirëpo edhe në vitin 2020 do të jetë më e lartë nga aktualja. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2019 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: **32.09 %**.

Tabela 6: Korniza Buxhetore Komunale 2019-2021, në euro.

Përshkrimi	2018	2019 (plani)	2020 (vlerësimet)	2021 (vlerësimet)
1. TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	13.698.231	13.658.892	14.104.146	14.620.755
1.1 Të hyrat vetanake	1.650.027	1.168.767	1.209.069	1.249.371
1.2 Grantet dhe transferet qeveritare	11.862.730	12.321.510	12.895.077	13.371.388
2. SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	13.309.970	13.658.892	14.104.146	14.620.755
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	9.222.129	9.253.383	9.408.662	9.951.980
Pagat dhe mëditjet	7.296.623	7.391.529	7.420.144	7.630.098
Mallrat dhe shërbimet	1.563.385	1.409.704	1.443.274	1.731.312
Shpenzime komunale	250.500	255.500	285.244	310.570
Subvencionet	191.322	196.650	260.000	280.000
2. Shpenzimet Kapitale	4.396.403	4.405.509	4.695.481	4.668.775
SUFICIT / DEFICIT	0	0	0	0
Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale				
3. BILANCI PRIMAR BUXHETOR				
3.1 Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm				
4. BILANCI TOTAL BUXHETOR				
5. FINANCIMI				
5.1 Financimi i jashtëm				
Ripagimi i borxhit kryesor				
Huamarrja e jashtme	185.474	168.615	134.899	
5.2 Financimi i brendshëm				
Shitja e aseteve				
Huamarrja e brendshme				
Ndryshimi në fitimet e pashpërndara				
6. BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT				

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve ne komune në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim (tabela 7) janë ato aktualet të vitit 2018, planifikimi për vitin e ardhshëm 2019 si dhe projeksionet e vitit 2019-2021 do të behën pas përgatitjes së buxhetit në shtator (Tabela 8-9-10).

Tabela 7: Shpenzimet në vitin 2018, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:

Drejtoria	Paga	Mallra dhe sherbiem	Sherbime komunale	Subvencione	Investime	Totali
Zyra e kryetarit	160,908	40,000	0	71,322	0	272,230
Administrata	214,228	98,500	0	0	65,000	377,728
Barazia gjinore	5,078	1,500	0	0	0	6,578
Inspekcioni	69,272	15,000	0	0	40,000	124,272
Kuvendi	102,530	20,000	0	0	0	122,530
Buxhet e financa	79,402	35,109	0	0	46,273	160,784
Sherbime publike	27,132	576,095	101,000	0	2,020,000	2,724,227
Zjarrefikuesit	140,101	20,500	0	0	25,000	185,601
ZLK	59,783	16,500	0	0	51,685	127,968
Bujqesia	62,396	15,000	0	10,000	447,543	534,939
Ekonomia	44,359	14,000	0	5,000	40,000	103,359
Kadastra	63,495	14,000	0	0	60,000	137,495
Urbanizmi	39,937	15,000	0	0	490,000	544,937
Shendetesia	878,651	307,198	60,000	50,000	450,848	1,746,697
QPS	87,266	12,000	4,500	5,000	0	108,766
Kulture,R. Sport	64,562	28,000	0	50,000	245,000	387,562
Adm/Arsim	49,359	41,000	0	0	415,053	505,412
Arsimi parafillor	45,510	16,000	5,000	0	0	66,510
Arsimi fillor	4,049,309	214,197	61,086	0	0	4,324,592
Arsimi mesem	1,053,345	63,786	18,914			1,136,045
	7,296,623	1,563,385	250,500	191,322	4,396,402	13,698,232

Tabela 8: Shpenzimet për 2019, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:

Drejtoria	Paga	Mallra dhe sherbiem	Sherbime komunale	Subvencione	Investime	Totali
Zyra e kryetarit						
Administrata						
Barazia gjinore						
Inspekcioni						
Kuvendi						
Buxhet e financa						
Sherbime publike						
Zjarrefikesiit						
ZLK						
Bujqesia						
Ekonomia						
Kadastra						
Urbanizmi						
Shendetesia						
QPS						
Kulture,R. Sport						
Adm/Arsim						
Arsimi parafillor						
Arsimi fillor						
Arsimi mesem						
		0	0	0	0	0

Tabela 9: Shpenzimet , projeksionet 2020, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe:

Drejtoria	Paga	Mallra dhe sherbiem	Sherbime komunale	Subvencione	Investime	Totali
Zyra e kryetarit						
Administrata						
Barazia gjinore						
Inspekcioni						
Kuvemdi						
Buxhet e financa						
Sherbime publike						
Zjarrefikesiit						
ZLK						
Bujqesia						
Ekonomia						
Kadastra						
Urbanizmi						
Shendetesia						
QPS						
Kulture,R. Sport						
Adm/Arsim						
Arsimi parafillor						
Arsimi fillor						
Arsimi mesem						
		0	0	0	0	0

Tabela 10: Shpenzimet, projeksionet 2021, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe :

--	--	--	--	--	--	--

Drejtoria	Paga	Mallra dhe sherbiem	Sherbime komunale	Subvencione	Investime	Totali
Zyra e kryetarit						
Administrata						
Barazia gjinore						
Inspekcioni						
Kuvendi						
Buxhet e financa						
Sherbime publike						
Zjarrefikesiit						
ZLK						
Bujqesia						
Ekonomia						
Kadastra						
Urbanizmi						
Shendetesia						
QPS						
Kulture,R. Sport						
Adm/Arsim						
Arsimi parafillor						
Arsimi fillor						
Arsimi mesem						
	0	0	0	0	0	0

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më larte paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Rahovecit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Prandaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikim i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Rahovecit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

3.4 Analiza Gjinore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por jemi përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet në paga dhe mëditje janë ndarë për të adresuar planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave të punësuar në kuadër të komunës, dhe i paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Sqarim: Tabela e me poshtme bazohet në shifrat sipas listës së pagave dhe mëditje të qershorit 2018 dhe numrin aktual të të punësuarve.

	Struktura e të punsuarve sipas gjinis – listat e pagave					% STRUKT
	Femra	%	Meshkuj	%	Total	
ZYRA E KRYETARIT	3	15.00	17	85.00	20	
ADMINISTRATA	8	18.18	36	81.82	44	
INSPEKZIONI	0	0.00	12	100.00	12	
ZYRA E KUVENDIT	11	35.48	20	64.42	31	
BUXHET E FINANCA	3	23.08	10	76.92	13	
SHERBIME PUBLIKE	0	0.00	4	100.00	4	
DREJTORIA PER MBROJTJE DHE SHPETIM	0	0.00	21	100.00	21	
ZLK	5	55.55	4	44.45	9	
BUJQESIA	0	0.00	11	100.00	11	
EKONOMIA	1	14.29	6	85.71	7	
KADASTRA GJEODEZIA	0	0.00	11	100.00	11	
URBANIZMI	2	33.33	4	66.67	6	
KRS	0	0.00	13	100.00	13	
DREJTORIA E ARSIMIT	0	0.00	6	100.00	6	
DREJT SHENDETESISE	0	0	0	0	0	
QPS	4	26.67	11	73.33	15	

Struktura gjinore e të punësuarave në arsim sipas listës së pagave Qershor-2017					
Të punësuar	Meshkuj	%	Femra	%	Total
DKA	6	100	0	0	6
Drejtor/eshë	29	82.86	6	17.14	35
Zv. drejtor/eshë	1	100	0	0	1
Sekretar/eshë	1	100	0	0	1
Profesor/eshë	92	63.45	53	36.55	145

Arsimtar/e	304	56.19	237	43.81	541
Edukator/e	0	0	39	100	39
Punëtor ndihmës/e	87	97.75	2	2.25	89
Klasa speciale	1	33.33	2	66.67	3
Bibliotekë	0	0	0	0	0
Total	521	60.58	39.42	339	860

Struktura Gjimore e te punësuarve në Shëndetësi sipas listës së pagave - Qershor 2017					
	Meshkuj	%	Femrave	%	Total:
Drejtor	2	100	0	0	2
Mjek	23	79.31	6	20.69	29
Teknik	20	27.78	52	72.22	72
Të tjerë	22	88	3	12	25

Komuna do ti përdorur më pas të dhënat specifike gjimore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor ne paga dhe mëditje në buxhetet e vitit 2018 për të përgatitur buxhetin në të ardhmen duke respektuar buxhetin e përgjithshëm gjinor. Tek investime kapitale, kur një projekt është për një qytet të caktuar apo të një fshatit, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj. ne do te përdorim të dhënat e ndarjes të popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë ne do te përdorur numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale) ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë nga viti 2011.

Drejtori për buxhet dhe financa

Kryetari i komunës

